



Republika e Kosovës

Republika Kosovo / Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës Rahovec

Opština Skupština Rahovac/Municipality of Rahovec

REPUBLICA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVAC/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC

KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 2845 Nr. i faq/Br.str/No.pg 56
Data/Datum/Date 14 / 10 / 22
RAHOVEC / ORAHOVAC

PROCESVERBAL I DËGJIMIT PUBLIK NGA KPF-JA PËR PROJEKT BUXHETIN E VITIT 2023

INFORMATË RRETH NJOFTIMIT

Njoftimi për organizimin e konsultimit publik për projekt buxhetin e vitit 2023 dhe KAB-in për vitet 2023-2025, u publikua me datë: 10.06.2022 në ueb faqen e komunës së Rahovecit, në të dy gjuhët, në këtë vegëz: <https://kk.rks-gov.net/rahovec/wp-content/uploads/sites/23/2022/09/Njofim-Publik-12.09.2022-1.pdf> në harmoni me afatet ligjore që i përcakton Udhëzimi Administrativ (MAPL) Nr.06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna .

Njoftimi përveç që është publikuar në uebfaqe të komunës, në Platformën për Konsultime Publike, në rrjetin social Facebook, njoftimi u është dërguar edhe kryetarëve të këshillave të fshatrave dhe lagjeve urbane përmes rrjeteve sociale Viber dhe WhatsApp.

DËGJIMI PUBLIK

Duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ (MAPL) NR. 06/2018 për STANDARDET MINIMALE TË KONSULTIMIT PUBLIK NË KOMUNA, Udhëzim Administrativ ky që ka për qëllim nxitjen dhe sigurimin nga ana e autoriteteve lokale të pjesëmarrjes së qytetarëve dhe palëve të tjera të interesuara gjatë procesit të politikëbërjes dhe vendimmarrjes në nivel lokal, të promovoj transparencë komunale, si dhe të ndikoj në zhvillimin e politikave të qëndrueshme në interes të përgjithshëm, Kuvendi Komunal i Rahovecit, respektivisht Komiteti për Politikë dhe Financa mbajtën **dëgjimin publik për projekt buxhetin e vitit 2023.**

Dëgjimi publik filloi në orën: **10: 00**

Dëgjimin e kryesoi:

- *Kryesuesi i Kuvendit z. Defrim Kafexhiu, dhe*

Nga radhët e Komitetit për Politikë dhe Financa ishin prezent:

1. Burim Krasniqi,
2. Besmira Bytyqi,
3. Melinda Iska,
4. Bejtullah Deliu.

Të pranishëm në konsultim ishin dhe kryetarët e fshatrave dhe lagjeve urbane të qytetit.

Numri i pjesëmarrësve në konsultim ishte: **16**

BLERTA GASHI

2

Numri i femrave pjesëmarrëse ishte: 8

Dëshmi janë listat e nënshkrimeve të pjesëmarrësve në dëgjim.

Dëgjimin e shpalli të hapur kryesuesi i Kuvendit Komunal, z.Defrim Kafexhiu.

Defrim Kafexhiu, kryesues i Kuvendit Komunal Rahovec: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, të nderuar kryetarë të fshatrave dhe lagjeve urbane të qytetit, të nderuar anëtarë të KPF-sëm të nderuar të pranishëm. Mirë se keni ardhur në takimin e ciklit të dytë të dëgjimeve buxhetore, të cilat I organizon Komiteti për Politikë dhe Financa, bashke me ne kemi Melinda Oruqi-Iska nga PDK, Besmira Bytyqi nga AAK, Burim Krasniqi-LDK dhe unë Defrim Kafexhiu nga VV si kryesues i komitetit. Të nderuar ju njoftoj që buxheti i Komunës së Rahovecit për vitin 2023 do të jetë 17,548,240.00 Euro, prej tyre:

Pagat dhe Mëditjet	8.458.000.00
Mallrat dhe Shërbimet	2.203.000.00
Shpenzimet Komunale	370.000.00
Subvencionet dhe Transferet	820.000.00
Shpenzimet Kapitale	5.701.000.00

Ku për dallim prej vitit të kaluar kemi një rritje prej 2 milion e 500 mijë eurosh. Prej investimeve kapitale që ia vlen të theksohet është Ndërtimi I sheshit qendror, projekt ky I cili prej buxhetit 2023 janë të ndara 700 mijë euro dhe me investime në vitet pasardhëse prej buxhetit komunal deri në vitin 2025 janë të ndara diku 4 milion e 450 mijë euro, poashtu kemi edhe projekte tjera, në Kulturë, Rini dhe Sport janë të ndara diku 2 milion e 114 e 549 euro, që ia vlen të ceket njëri project si vazhdim Ndërtimi i Qendrës Rinore, në Arsim dhe shkencë janë të ndara 2 milion e 247 mijë euro, Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale 2 milion e 570 mijë euro. Në Shërbime publike kemi 970 mijë euro, në ekonomi 157 mijë euro. Ky afërsisht është buxheti 2023. Është takimi I fundit I ciklit të dëgjimeve buxhetore, edhe I atyre të kryetarit edhe të KPF-së. Nëse dikush prej juve ka ndonjë pyetje e keni hapësirën për ta parashtruar.

Naser Dula-Drejtor I shkollës së Muzikës- Përshëndetje veç desha të pyes, kjo Qendra Rinore është Qendra Inovative, I cili ka qenë project ideor, apo diçka tjetër?

Defrim Kafexhiu, kryesues i Kuvendit Komunal Rahovec- Profesor faleminderit për pyetjen, por, mënyra e organizimit të dëgjimeve buxhetore është vetëm marrja e kërkesave, kurse trajtimi I tyre do të bëhet përmes Raportit Final. Ne si KPF dhe si Kuvend i shqyrtojmë kërkesat e dëgjimeve buxhetore, dhe para miratimit të buxhetit shohim nëse kërkesat përputhen me ato projekte të cilat ekzekutivi I ka future në buxhetin e vitit 2023.

Naser Dula-Drejtor I shkollës së Muzikës- Mua më intereson objekti I shkollës së Muzikës a është i përfshirë, por, mesa duket jo.

Arbnor Kabashi- Unë si përfaqësues I fshatit Opterushë, desha të bëj një kërkesë për ndriçimin public dhe për drunjte dekorativ, ndërrimin e drunjve dekorativ ngaqë janë tharë.

Defrim Kafexhiu- Faleminderit, dikush tjetër? Atëherë ju faleminderit shumë për pjesëmarrje. Pas këtij konsultimi do të përgatitet dhe procesverbali dhe gjitha kërkesat do të evindentohen pastaj do të shqyrtohen se a do të futen në buxhet ose jo.

Konsultimi publik përfundoi në orën: 10:30

DËSHMI NGA KONSULTIMI



BLERTA GASHI

4

Dokumentin e procesverbalit e punoi

Blerta Gashi



Zyrtare përgjegjëse për koordinimin e konsultimeve publike



Rahovec,

Tetor, 2022

BLERTA GASHI

5